



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

# **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

## **“MAKINA METALPUNUESE”**

### **Niveli III në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit III KEK<sup>2</sup>**

### **F1-III-23**

Tirane, 2023

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Makina metalpunuese			Kodi <b>F1-III-23</b>
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar niveli III në KEK	
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Makina metalpunuese”, Niveli III KSHK, referuar niveli III në KEK është: “Zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar si punëtor i kualifikuar për përdorimin e makinave metalpunuese për fushën e mekanikës, të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën përkatëse, si dhe për të vijuar arsimin dhe formimin në nivele më të larta”.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në profilin “Makina metalpunuese” niveli III-të në KSHK, referuar niveli III në KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> <li>- kanë mbaruar dy vitet e para të shkollës së mesme të drejtimit “Mekanikë”; niveli II në KSHK, referuar niveli III në KEK</li> <li>- janë në gjendje shëndetësore të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.</li> </ul>			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional në “Makina metalpunuese”, niveli III-të në KSHK, referuar niveli III në KEK, e pajis individin me certifikatën dhe suplementin përkatës të punëtorit të kualifikuar në këtë fushë. Ky kualifikim i jep mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje të shërbimeve mekanike, në pika shërbimi të makinave të përpunimit mekanik të detaleve, në reparte mirëmbajtje të ndërmarrje të ndryshme, në njësi të shitjeve të materialeve dhe veglave të punës, si dhe në veprimtari të tjera që ushtrohen në këtë drejtim. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e mekanikës të përmendura më sipër.  Me përfundimin e arsimit në kualifikimin “Makina metalpunuese” niveli III-të në KSHK, referuar niveli III në KEK, ai/ajo ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin IV në KSHK, referuar niveli IV në KEK, duke fituar të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Data e validimit	Korrik 2023			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	<b>F-II-01-12, F1-III-19</b>			

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

## Rezultatet e të nxënit në:

Në përfundim të kualifikimit profesional “Makina metalpunuese” niveli III-të në KSHK, referuar niveli III të KEK individit do të përforcojë njohuritë profesionale të fituar në Nivelin II, si dhe do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

## NJOHURI PROFESIONALE

### Planifikimi dhe organizimi i punës

- Të shpjegojë rëndësinë e punimeve në makinat metalpunuese;
- Të përshkruajë ndërtimin, funksionimin dhe organizimin e ndërmarrjeve, reparteve dhe serviseve të ndryshme të punimeve në makineri metalpunuese;
- Të përshkruajë makineritë dhe pajisjet e nevojshme të një ndërmarrje, reparti të punimeve në makina metalpunuese, sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;;
- Të listojë instrumentet matëse, kontrolluese dhe prerëse në një repart të përpunimit mekanik;
- Të shpjegojë rëndësinë e konsultimit dhe koordinimit me teknikë të tjerë;
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe përzgjedhjes të burimeve njerëzore sipas proceseve të punës;
- Të përshkruajë mënyrat e planifikimit dhe përzgjedhjes së makinave metalpunuese;
- Të përshkruajë mënyrat e planifikimit dhe përzgjedhjes së mjeteve, veglave, pajisjeve të nevojshme të punës;
- Të shpjegojë mënyrat e planifikimit dhe përzgjedhjes së instrumenteve matëse dhe kontrolluese;
- Të shpjegojë një vizatim pune, përmasat, tolerancat dhe ashpërsitë e sipërfaqeve;
- Të interpretojë simbolet dhe shënimet e ndryshme të vizatimit të punës;
- Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së parafabrikatit pas analizës së vizatimit të detalit;
- Të shpjegojë llojet e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse sipas përdorimit të tyre;
- Të shpjegojë mënyrat e planifikimit dhe sigurimit të lëndëve të para për makinat metal punuese;
- Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të kohës së punës për punimet që do kryejë;
- Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të funksionalitetit të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive të punës;
- Të përshkruajë procedurën e përgatitjes të vendit të punës përpara fillimit të punës në makinat metalpunuese;
- Të përshkruajë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
- Të shpjegojë mënyrat dhe mjetet e punës për pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës.
- Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së detyrave në ekip;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullores së brendshme;

- Të përshkruajë rëndësinë e rregullit dhe mirëmbajtjes të vendit të punës;

### **Përgatitja për punë makinerive metalpunuese**

- Të shpjegojë mënyrën e përzgjedhjes së instrumenteve metalpunues sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Të shpjegojë mënyrën e përzgjedhjes të regjimeve të punës së makinerive metalpunuese, sipas kartës teknologjike;
- Të shpjegojë mënyrën e përzgjedhjes së pajisjeve ndihmëse të nevojshme për prodhimin e produktit, në makinat metalpunuese, sipas manualit të makinerive dhe proceseve të punës;
- Të shpjegojë procesin e atrecimit të makinerive dhe pajisjeve metalpunuese për prodhimin e produktit, sipas manualeve përkatëse.

### **Materialët, instrumentet prerës, matës dhe kontrollues**

- Të shpjegojë mënyrën e klasifikimit të materialeve, sipas kritereve përkatës;
- Të shpjegojë përbërjen kimike dhe vetitë fiziko-mekanike të gizës, çelikut dhe metaleve me ngjyra sipas përdorimit të tyre;
- Të shpjegojë materialet metalike dhe jo metalike për punime në makinat metalpunuese sipas përdorimit të tyre;
- Të listojë markat e çeliqueve dhe lidhjeve të forta për instrumente matës e prerës;
- Të shpjegojë mënyrat e trajtimeve termike të markave të çeliqueve dhe lidhjeve të forta për instrumentet matës dhe prerës;
- Të shpjegojë mënyrën e klasifikimit të instrumenteve dhe pajisjeve matëse dhe kontrolluese për punime në makinat metalpunuese;
- Të shpjegojë përdorimin e të instrumenteve e pajisjeve matëse dhe kontrolluese gjatë punimeve në makinat metalpunuese;
- Të shpjegojë rëndësinë e regjistrimit dhe kalibrimit të instrumenteve dhe pajisjeve matëse dhe kontrolluese;
- Të shpjegojë mënyrën e klasifikimit të instrumenteve prerës për punime në makinat metalpunuese;
- Të shpjegojë ndikimin e gjeometrisë së instrumentit prerës në punimet në makinat metalpunuese;
- Të shpjegojë mënyrat e mpohjes së instrumenteve prerës në makina metalpunuese;

### **PUNIME NË MAKINERI METALPUNUESE**

#### **Të përgjithshme :**

- Të përshkruajë veçoritë e procesit të prodhimit dhe procesit teknologjik;
- Të përshkruajë përdorimin e kartës teknologjike të detaleve;
- Të interpretojë preventivin e punimeve për produktin;
- Të shpjegojë shtesat e punimit mekanik në varësi nga lloji i punimit;
- Të përshkruajë punimin mekanik të detaleve në makineritë metalpunuese, lëvizjet e punës, llojet e tyre;
- Të shpjegojë mënyrën e vendosjes së lëndës së parë në makineritë metalpunuese ;
- Të përshkruajë mënyrën e vendosjes së instrumenteve prerës në makineritë metalpunuese ;
- Të përshkruajë elementët e regjimit të prerjes në makineritë metalpunuese ;

- Të shpjegojë përdorimin e lëngjeve ftohëse në procesin e prerjes;
- Të shpjegojë mënyrën e montimit të pajisjeve ndihmëse dhe atrecaturës së nevojshme në makineritë metalpunuese ;
- Të dallojë ndryshimet ndërmjet makinave konvencionale dhe atyre me programim numerik CNC;

#### **Punime në makinat tornuese :**

- Të përshkruajë ndërtimin e llojeve të ndryshme të makinave tornuese (universale, revolver, vertikale, automatike, speciale etj. );
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e makinave tornuese me programim numerik CNC;
- Të listojë punimet që kryhen me makinat tornuese ;
- Të përshkruajë punimin e detaleve tip boshti;
- Të përshkruajë punimin e sipërfaqeve të brendshme;
- Të përshkruajë punimin e sipërfaqeve të jashtme;
- Të përshkruajë punime të tjera që kryhen në makinat tornuese;
- Të përshkruajë pajisjet ndihmëse në makinat tornuese (pllatotë, lunetat, kundramajat etj.);

#### **Punime në makinat frezuese :**

- Të përshkruajë ndërtimin e llojeve të ndryshme të makinave frezuese ( horizontale, vertikale, për prodhimin e rrotave të dhëmbëzuara, speciale etj. );
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e makinave frezuese me programim numerik CNC;
- Të listojë llojet e frezimit që kryhen në makinat frezuese ( ballor, i rrafshët, rrethor etj. );
- Të përshkruajë llojet e instrumenteve frezues;
- Të shpjegojë gjeometrinë e instrumenteve frezues, ndikimin e tyre në procesin e punës;
- Të përshkruajë pajisjet ndihmëse në makinat frezuese ( shtrënguesit, mbështetësit etj. );
- Të përshkruajë kokën ndarëse, ndërtimin dhe përdorimin e saj;
- Të shpjegojë ndarjen diferenciale në makinat frezuese;
- Të shpjegojë punimin e rrotave të dhëmbëzuara cilindrike;
- Të shpjegojë punimin e rrotave të dhëmbëzuara konike;
- Të shpjegojë punime speciale në makinat frezuese;

#### **Punime në makinat zdruguese :**

- Të listojë lloje të ndryshme të makinave zdruguese ( limatriçe, stokatricë, pjalë etj.);
- Të përshkruajë ndërtimin e llojeve të ndryshme të makinave zdruguese ( horizontale, vertikale, për prodhimin e rrotave të dhëmbëzuara etj.);
- Të listojë llojet e punimeve në makinat zdruguese;
- Të listojë llojet e instrumenteve prerës në makinat zdruguese;
- Të përshkruajë pajisjet ndihmëse në makinat zdruguese;

#### **Punime në makinat barenuese**

- Të përshkruajë ndërtimin e llojeve të ndryshme të makinave barenuese;
- Të listojë llojet e punimeve në makinat barenuese;

### **Punime në makinat retifikuese**

- Të përshkruajë ndërtimin e llojeve të ndryshme të makinave retifikuese (rrethore, universale, pa qendra, speciale etj. ) ;
- Të listojë llojet e punimeve në makinat retifikuese;
- Të përshkruajë llojet e instrumenteve abrazivë ( pllakat dhe gurët retifikues);
- Të shpjegojë ndërtimin, materialet dhe karakteristikat e instrumenteve për retifikim;
- Të përshkruajë procesin e honingimit, lapimit, superfinishit dhe polirimit;

### **Punime në makinat shpuese dhe filetuese**

- Të përshkruajë ndërtimin e llojeve të ndryshme të makinave shpuese ( horizontale, vertikale, speciale etj. )
- Të listojë llojet e punimeve që kryhen në makinat shpuese dhe filetuese;
- Të listojë llojet e instrumenteve shpues;
- Të përshkruajë pajisjet ndihmëse në makinat shpuese;
- Të shpjegojë llojet e punimeve të filettimeve dhe mënyrën e realizimit të tyre;

### **Punime në makinat kthyesë dhe prerëse**

- Të përshkruajë ndërtimin e llojeve të ndryshme të makinave me deformim plastik;
- Të përshkruajë llojet dhe ndërtimin e makinave kthyesë (piegatriçe);
- Të listojë llojet e punimeve në makinat kthyesë;
- Të përshkruajë llojet dhe ndërtimin e makinave kalandruese;
- Të shpjegojë procesin e kalandrimit;
- Të përshkruajë llojet dhe ndërtimin e makinave prerëse manuale (tranxhe dore, tranxhë mekanike etj.);
- Të përshkruajë llojet dhe ndërtimin e sharrave shirit për prerje;
- Të përshkruajë llojet dhe ndërtimin e pajisjeve dhe makinave prerëse elektrike dhe elektrohidraulike;
- Të përshkruajë përdorimet e makinerive prerëse me plazëm, me rreze lazer dhe me presion uji ;
- Të listojë lloje të ndryshme të instrumenteve në procesin e prerjes;
- Të përshkruajë pajisjet ndihmëse në makinat prerëse;
- Të shpjegojë punimet e axhusterisë, qëllimin dhe mënyrat e realizimit të tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e përpunimi kimiko-termik të materialeve;
- Të shpjegojë rastet e defekteve (plasaritje, sforcim, deformacione);

### **Kontrolli përfundimtar dhe dorëzimi i produktit**

- Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e kontrollit përfundimtar të produktit;
- Të shpjegojë rëndësinë e informimit në kohë të mbarimit të procesit të prodhimit;
- Të përshkruajë mënyrat e dokumentimit të përfundimit të procesit të punës;
- Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e identifikimit të parregullive të mundshme të produktit;
- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të tolerancave të dhëna në vizatimin teknik dhe në kartën teknologjike gjatë punimeve mekanike;
- Të përshkruajë shmangiet nga vizatimi i punës dhe mënyrën e shënimit dhe korigjimit të tyre;

- Të listojë masat e mara për korrigjimin e parregullsive të mundshme;
- Të listojë teknikat, mjetet dhe materialet e pastrimit, shënimit dhe markimit të produktit përfundimtar;
- Të listojë llojet e grasove dhe vajrave lubrifikantë që përdoren për ruajtjen e produktit;
- Të përshkruajë përdorimin e veglave dhe pajisjeve dhe për grasatimin dhe vajosjen e produktit;
- Të listojë pajisjet dhe materialet e paketimit të produktit përfundimtar;
- Të përshkruajë mënyrat e dorëzimit të produktit përfundimtar te klienti;

### **Mirëmbajtja e pajisjeve dhe makinerive në punimet metalpunuese**

- Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes të elementëve të makinerive metalpunuese;
- Të listojë proceset e punës për mirëmbajtjen e makinerive metalpunuese;
- Të shpjegojë përdorimet e informacionit nga burime të ndryshme për shërbimet e mirëmbajtjes së makinerive metalpunuese;
- Të shpjegojë mënyrën e marrjes së informacionit nga instruksionet e prodhuesit për shërbimet e mirëmbajtjes;
- Të shpjegojë rëndësinë e shërbimeve të mirëmbajtjes së makinave metalpunuese;
- Të interpretojë dokumentacionin teknik të mirëmbajtjes të pajisjeve dhe makinerive metalpunuese;
- Të përshkruajë veglat, pajisjet dhe materialet që përdoren për mirëmbajtjen e makinerive metalpunuese, duke argumentuar rëndësinë e tyre;
- Të shpjegojë periudhën e mirëmbajtjes së makinerive metalpunuese, në varësi të përdorimit të tyre. (vjetor/orë pune).

### **Sipërmarrja dhe edukimi i karrierës**

- Të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e sipërmarrjes së biznesit;
- Të përshkruajë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;
- Të shpjegojë kuptimin e bankave dhe shërbimet e tyre;
- Të shpjegojë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të shpjegojë rëndësinë e detyrimeve tatimore, kodin e punës, akteve ligjore në fushën e prodhimit në makineritë metalpunuese;
- Të shpjegojë mënyrën e hartimit të planeve ditore, javore, mujore të punës në përputhje me detyrat;
- Të përshkruajë mënyrën e pasqyrit të të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara për klientët në regjistrat e duhur;
- Të shpjegojë mënyra e përgatitjes së një oferte;
- Të shpjegojë mënyrat e ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit;
- Të përshkruajë llogaritjet e kostos së mjeteve, pajisjeve, materialeve dhe makinerive;
- Të rendisë mënyrat e përgatitjes së një oferte për punimet/shërbimet që do të kryejë;
- Të shpjegojë mënyrat e furnizimit me mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe makinerive të nevojshme;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të çmimeve të tregut të mjeteve, pajisjeve, materialeve dhe makinerive;
- Të shpjegojë elementet e llogaritjes së kostos përfundimtare për punimet e ofruara;
- Të përshkruajë mënyrën dhe formatet e përgatitjes së raporteve periodike për punimet;

- Të përshkruajë mënyrën e plotësimit të dokumentacionit teknik dhe financiar për punimet e kryera në makinat metalpunuese.
- Të shpjegojë rëndësinë dhe nevojën e përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;
- Të përshkruajë metodat dhe kriteret e vlerësimit të performancës;
- Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit të njohurive për aplikimin e teknikave e reja në punë;
- Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me specialistët e tjerë në fushën e makinave metalpunuese;
- Të shpjegojë rëndësinë e pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me ngritjen profesionale të tij;

### **Komunikimi dhe etika profesionale**

- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit dhe teknikat përkatëse të tij;
- Të përshkruajë rëndësinë e shkëmbimit të informacionit mbi problemet dhe të rejat e ditës;
- Të përshkruajë parimet dhe domosdoshmërinë e punës në grup;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të hierarkisë;
- Të përshkruajë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e kodit të etikës dhe zbatimit të tij;
- Të këmbëjë udhëzime/procedura me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës, duke pranuar mendimin kritik;
- Të shpjegojë teknikat e zgjidhjes së problemeve dhe mosmarrëveshjeve;
- Të respektojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim;

### **Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit**

- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar dhe ndërkombëtar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të manualeve të përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve dhe makinerive, sipas standardeve;
- Të përshkruajë masat për garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë në reparte të makinave metalpunuese;
- Të listojë llojet e aksidenteve të mundshme gjatë veprimtarisë së kryerjes së punimeve në makinat metal punuese dhe mënyrën e shmangies së tyre;
- Të listojë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të shpjegojë elementët e sinjalistikës të vendosura në mjediset e punës;
- Të përshkruajë planin dhe procedurat e evakuimit në raste emergjence;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
- Të përshkruajë rregullat e përdorimit të pajisjeve të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH);
- Të shpjegojë rreziqet dhe masat përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik të ruajtjes, magazinimit të solucioneve kimike;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve dhe zhvendosjeve të ngarkesave dhe peshave të rënda;



- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me pajisje fikse dhe të lëvizshme;
- Të përshkruajë rastet kryesore të ndotjes së ambientit dhe masat përkatëse për eliminimin e tyre;
- Të përshkruajë parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të përshkruajë procedurat e duhura për ndarjen e mbetjeve sipas llojit në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit racional të lëndëve të para, veglave të punës dhe të energjisë;
- Të përshkruajë zbatimin e protokolleve të duhura në raste pandemie;

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Në përfundim të kualifikimit profesional në “Makina metalpunuese” niveli III, në KSHK individi do të përforcojë shprehinë profesionale të fituar në Nivelin II, si dhe do të zotërojë shprehinë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

### **Planifikimi dhe organizimi i punës**

- Të organizojë punën në makineritë metalpunuese të një ndërmarrje apo reparti;
- Të koordinojë punën me specialistë dhe teknikë të tjerë;
- Të planifikojë burimet njerëzore sipas proceseve të punës
- Të planifikojë makineritë metalpunuese;
- Të planifikojë mjetet, veglat, pajisjet e nevojshme të punës;
- Të planifikojë instrumentet matës dhe kontrollues;
- Të planifikojë lëndët e para për makinat metalpunuese;
- Të interpretojë simbolet dhe shënimet e ndryshme të vizatimit të punës;
- Të përgatisë gjysmëproduktin pas analizës së vizatimit të detalit;
- Të kryejë llogaritje paraprake të kohës për punimet që do kryejë;
- Të kontrollojë funksionalitetin e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive të punës;
- Të përgatisë vendin përpara fillimit të punës në makinat metalpunuese;
- Të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- Të kryejë pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës;
- Të ndajë detyrat në ekip;
- Të zbatojë rregulloren e brendshme të repartit;

### **Përdorimi i instrumenteve metalpunues, kontrolluese dhe matëse**

- Të përzgjedhë gjysmëproduktin për punime në makinat metalpunuese, sipas përbërjes kimike dhe vetive fiziko-mekanike;
- Të përzgjedhë instrumentet për punime në makinat metalpunues sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Të përzgjedhë instrumentet matëse e kontrolluese, sipas vizatimit dhe procesit të punës, në makinat metalpunuese;
- Të regjistrojë dhe kalibrojë instrumentet matëse dhe kontrolluese;
- Të përdorë instrumentet matëse e kontrolluese gjatë punimeve në makinat metalpunuese;

- Të përzgjedhë instrumentet dhe pajisjet prerëse, sipas vizatimit dhe procesit të punës, në makinat metalpunuese;
- Të kryejë mprehjen e instrumenteve prerës të përdorura në makina metalpunuese;

## **PUNIME NË MAKINERI METALPUNUESE**

### **Të përgjithshme :**

- Të zbatojë standardet e kërkuara në procesin e prodhimit dhe atë teknologjik;
- Të lexojë kartën teknologjike të detaleve gjatë punës në makineritë metalpunuese;
- Të zbatojë grafikun e punimeve për produktin;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat për montimin e pajisjeve ndihmëse dhe atrecaturës së nevojshme në makineritë metalpunuese;
- Të përzgjedhë lëngjet ftohëse në procesin e prerjes;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat për vendosjen e gjysmëproduktit në makineritë metalpunuese;
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat për vendosjen e instrumenteve prerës në makineritë metalpunuese ;
- Të përzgjedhë të regjimin e punës së makinerive metalpunuese, sipas kartës teknologjike;
- Të kryejë punime të detaleve në makineritë metalpunuese duke pasur parasysh lëvizjet e punës në to ( lëvizja e thikës, e copës etj.);
- Të kryejë matje dhe kontrolle gjatë dhe pas punës;
- Të realizojë shtesat e punimit mekanik në varësi nga lloji i punimit;

### **Punime në makinat tornuese :**

- Të përzgjedhë llojin e makinës tornuese për punë ( universale, revolver, vertikale, automatike, speciale etj. );
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat për vendosjen në punë të makinave tornuese me programim numerik CNC;
- Të kryejë punime tornimi;
- Të kryejë punime në boshte;
- Të kryejë punime në sipërfaqe të brendshme;
- Të kryejë punime në sipërfaqe të jashtme;
- Të kryejë punime të tjera tornimi;
- Të përzgjedhë pajisjet ndihmëse në makinat tornuese (pllatotë, lunetat, kundramajat etj.);

### **Punime në makinat frezuese :**

- Të përzgjedhë llojin e makinës frezuese për punë ( horizontale, vertikale, për prodhimin e rrotave të dhëmbëzuara, speciale etj. );
- Të zbatojë procedurat dhe mënyrat për vendosjen në punë të makinave frezuese me programim numerik CNC;
- Të përzgjedhë instrumentin frezues me gjeometrinë përkatëse sipas përdorimit dhe saktësisë së punimit mekanik;
- Të përzgjedhë pajisjet ndihmëse në makinat frezuese ( shtrënguesit, mbështetësit etj. );
- Të vendosë kokën ndarëse në bangon e makinës frezuese për prerjen e rrotave të dhëmbëzuara;
- Të ndërtojë kokën ndarëse për prerjen e rrotës së dhëmbëzuar;

- Të realizojë punime frezimi (frezim ballor, i rrafshët, rrethor etj.);
- Të kryejë punime në rrotat e dhëmbëzuara;
- Të kryejë punime speciale frezimi;

#### **Punime në makinat zdruguese:**

- Të përzgjedhë llojin e makinës zdruguese për punë ( limatriçe, stokatriçe, pjalë etj. );
- Të përzgjedhë instrumentet prerës në makinat zdruguese;
- Të përzgjedhë pajisjet ndihmëse në makinat zdruguese;
- Të kryejë punime zdrugimi;

#### **Punime në makinat barenuese**

- Të përzgjedhë llojin e makinës barenuese për punë;
- Të kryejë punime barenimi;

#### **Punime në makinat retifikuese**

- Të përzgjedhë llojin e makinës retifikuese për punë (rrethore, universale, pa qendra, speciale etj.);
- Të përzgjedhë instrumentet abrazivë për retifikim ( pllakat dhe gurët retifikues);
- Të përzgjedhë pajisjet ndihmëse në makinat retifikuese;
- Të kryejë punime retifikimi të sipërfaqeve të sheshta;
- Të kryejë punime retifikimi të sipërfaqeve të jashtme cilindrike;
- Të kryejë punime honingimi, lapimi, superfinishi dhe polirimi;

#### **Punime në makinat shpuese dhe filetuese**

- Të përzgjedhë llojin e makinës shpuese (trapano bango, trapano kollonë, trapano radiale etj.).
- Të përzgjedhë instrumentin metalprerës për shpim;
- Të përzgjedhë pajisjet ndihmëse në makinat shpuese dhe filetuese;
- Të realizojë punime shpimi dhe filetimi;

#### **Punime në makinat me kthyes dhe prerëse**

- Të realizojë punime presimi;
- Të realizojë punime në makinat kthyes;
- Të kryejë punime kalandrimi;
- Të kryejë punime prerje, me heqje ashkle, me sharra mekanike;

#### **Kontrolli përfundimtar dhe dorëzimi i produktit**

- Të përzgjedhë mënyrat e kontrollit përfundimtar të produktit;
- Të informojë në kohë për mbarimin e procesit të prodhimit;
- Të kryejë dokumentimin e përfundimit të procesit të punës;
- Të identifikojë parregullsitë e mundshme të produktit;
- Të kontrollojë saktësinë e punimit mekanik duke e krahasuar me vizatimin e punës;
- Të përzgjedhë masat për korrigjimin e parregullsive të mundshme;

- Të përzgjedhë teknikat, mjetet dhe materialet e pastrimit, shënimit dhe markimit të produktit përfundimtar;
- Të përzgjedhë veglat dhe pajisjet për lyerjen e produktit të prodhuar;
- Të përzgjedhë llojet e grasove dhe vajrave lubrifikantë për ruajtjen e produktit;
- Të përzgjedhë pajisjet dhe materialet e paketimit të produktit përfundimtar;
- Të kryejë veshjen dhe paketimin e produktit me materiale mbrojtëse;
- Të kryejë dorëzimin e produktit përfundimtar te klienti;

### **Mirëmbajtja e pajisjeve dhe makinerive në punimet metalpunuese**

- Të zbatojë grafikun e mirëmbajtjes së makinerive metalpunuese;
- Të marrë informacion nga burime të ndryshme për shërbimet e mirëmbajtjes së makinerive metalpunuese;
- Të përcaktojë periudhën e mirëmbajtjes së makinerive metalpunuese, në varësi të përdorimit të tyre. (vjetor/orë pune).
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për mirëmbajtjen e makinerive metalpunuese;
- Të kryejë procedurat e mirëmbajtjes të pajisjeve ndihmëse të makinerive metalpunuese;
- Të kryejë shërbimet e mirëmbajtjes të makinave metalpunuese;
- Të kryejë lubrifikimin dhe grasatimin e pajisjeve sipas kërkesave specifike të tyre;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të mirëmbajtjes të pajisjeve dhe makinerive metalpunuese;
- Të kryejë pastrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të punës dhe instrumenteve;

### **Sipërmarrja dhe edukimi i karrierës**

- Të marrë informacion për nevoja dhe kërkesa të tregut për punime në makinat metalpunuese;
- Të kryejë veprime financiare me bankat;
- Të përzgjedhë mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të zbatojë legjislacionin në fuqi për detyrimet tatimore;
- Të zbatojë kodin e punës dhe rregulloren e brendshme;
- Të zbatojë akteve ligjore në fushën e prodhimit në makineritë metalpunuese;
- Të hartojë plane ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat;
- Të regjistrojë ofertat dhe faturat për klientët për punimet e kryera;
- Të kryejë ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit;
- Të analizojë çmimet e tregut lidhur me materialet, pajisjet e punës, si dhe punimet e kryera;
- Të llogarisë koston e mjeteve, pajisjeve, materialeve dhe makinerive;
- Të përgatisë oferta për punime që do të kryejë;
- Të kryejë furnizimin me mjete, materiale, pajisje dhe makineri të nevojshme;
- Të llogaritë çmimin përfundimtar për punimet e ofruara;
- Të hartojë raportet periodike për shërbimet e kryera;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik të nevojshëm për punimet e kryera në makinat metalpunuese;
- Të përdorë Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;
- Të përditësoj njohuritë për aplikimin e teknikave të reja në punë;

- Të bashkëpunojë me specialistët e tjerë në fushën e makinave metalpunuese;
- Të kryejë trajnime të vazhdueshëm sipas nevojës për rritje profesionale;
- Të marrë pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare për ngritjen profesionale të tij;

### **Komunikimi dhe etika profesionale**

- Të zbatojë teknikat e komunikimit;
- Të bashkëpunojë për problemet dhe të rejat e ditës;
- Të punojë në grup duke zbatuar parimet përkatëse;
- Të respektojë hierarkinë;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Të përdorë terminologjinë profesionale;
- Të zbatojë kodin e etikës;
- Të marrë dhe japë udhëzime me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës;
- Të zbatojë teknikat e duhura për zgjidhjen e problemeve dhe mosmarrëveshjeve;
- Të zbatojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikim;

### **Sigurimi teknik e mbrojtja e mjedisit**

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar dhe ndërkombëtar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të zbatojë manualët e përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve dhe makinerive, sipas standardeve;
- Të marrë masat për garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë në reparte të makinave metalpunuese;
- Të marrë masa për shmangien e aksidenteve gjatë veprimtarisë së kryerjes së punimeve në makinat metalpunuese;
- Të japë ndihmën së parë në rast aksidenti;
- Të respektojë sinjalistikën e vendosur në mjediset e punës;
- Të zbatojë planin dhe procedurat e evakuimit në raste emergjence;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat e përdorimit të pajisjeve të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH).
- Të marrë masat përkatëse gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik për ruajtjen, magazinimin dhe punimeve me lëngje të ndryshme (vaj, alkool, lëndë djegëse, bojë, solucionet kimike etj.);
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve dhe zhvendosjeve të ngarkesave dhe peshave të rënda;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me pajisje fikse dhe të lëvizshme;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik për përdorimin e energjisë elektrike, gjatë punimeve;
- Të respektojë masat e sigurisë kolektive lidhur me: grumbullimin e produkteve të prodhimit, sigurinë elektrike, mekanike, hidraulike, pneumatikë, përdorimin e mjeteve ngritëse dhe transportuese, përdorimin e gurëve smeril,...
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë duke përdorur pajisjet mbrojtëse individuale si: skufjet e flokëve (kur flokët janë të gjatë), kaskën, syzet maskë, syzet e saldimit, mbrojtëset e veshëve

( kufje ose tapa), këpucë me mbrojtëse metalike, maskën mbrojtëse të frymëmarrjes, dorezat kundër veprimeve mekanike ( shpimit, prerjes etj.).

- Të marrë masa për eliminimin e ndotjes së ambientit;
- Të zbatojë parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të zbatojë procedurat e duhura për ndarjen e mbetjeve dhe depozitimin e tyre sipas llojit në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Të përdor në mënyrë racionale lëndët e para, veglat e punës, makineritë dhe energjinë;
- Të zbatojë protokollet e duhura në raste pandemie;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me lëngje të ndryshem (vajrave ftohës, vajrave lubrifikante etj.);
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me gaz.
- Të zbatojë masat për mbrojtjen e ambientit (pastrimi, ventilimi, largimi i ashklave, vajrave të përdorur, depozitimi i elementeve të ndotur,...
- Të respektojë kolegët e tij duke përshtatur një sjellje korrekte profesionale.

## **KOMPETENCA TE PËRGJITHSHME**

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vet vlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.